



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD.nr. 14/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, U.D., Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, në çështjen e hetimit disiplinore, duke vepruar sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 17.11.2021, e parashtruar nga B.S., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit – ish gjyqtarit Xh.E., por edhe sipas detyrës zyrtar në lidhje me ankesën ndaj aktvendimit Ad.nr. 14/2021, me datë 15.12.2021 mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e parashtruar me datën 17.11.2021 nga B.S., nga Prizreni për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ish-gjyqtarit Xh.E.,.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës B.S., me datën 17.11.2021 ka parashtruar ankesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ish-gjyqtarit Xh.E., në lidhje me lëndën C .nr.....

U.D., Kryetari i Gjykatës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe ankesës së ankuesit gjeti se ankesa për fillimin e procedurës disiplinore **është e pa lejuar**.

U.D., Kryetari i Gjykatës thekson ish-gjyqtari Xh.E., me datën 16.08.2021 e ka përfunduar mandatin e gjyqtarit me pensionim andaj me nenin 7 par.3 te LIGJI Nr. 06/L - 057 pizR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE parashihet se *“Vendimi për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit ose prokurorit lëshohet edhe në rastet kur pas fillimit të procedurave disiplinore, gjyqtari ose prokurori ka lënë detyrën ose funksioni i te cilit si gjyqtar ose prokuror është ndërprerë në ndonjë mënyrë tjetër”* në rastin konkret kërkesa e palës është parashtruar me datë 17.11.2021 ndërsa ish- gjyqtari Xh.E., është në pension nga data 16.08.2021 pra kërkesa është iniciuar nga pala pas daljes në pension dhe jo sa ka qenë në detyrë ish - gjyqtari Xh.E., në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa për fillim të procedurës disiplinore. andaj edhe ankesa e parashtruar është e palejuar në kuptim të kësaj dispozite ligjore.

Andaj siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
AD.nr.14/2021 datë 15.12.2021

Kundër këtij aktvendimi nuk parashihet e drejta e ankesës.

